



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/56
Datë: 11.01.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 janar 2012, mori:

V E N D I M

1. Miratohet Strategjia dhe Plani i Veprimit Kundër Korrupsionit për vitin 2012-2016.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Strategjinë dhe Planin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/56
Datë: 11.01.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 16 paragrafi (2) të Ligjit për Partneritetet Publiko Privat nr. 04/L-045, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 janar 2012, mori:

V E N D I M

1. Emërohet Komiteti për Partneritet Publiko Privat në këtë përbërje të anëtarëve të përhershëm:
 - 1.1. Ministri i Financave, Kryesues
 - 1.2. Kryeministri i përfaqësuar nga Z. Bekim Çollaku, anëtar
 - 1.3. Ministri i Infrastrukturës, anëtar
 - 1.4. Ministrja e Tregtisë dhe Industrisë, anëtare
 - 1.5. Ministri i Zhvillimit Ekonomik, anëtar
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/56
Datë: 11.01.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 janar 2012, mori:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në shumë prej 400,000.00 (katërqind mijë) euro për mbulimin e shpenzimeve për dëmet e shkaktuara nga era për komunën e Istogut, Pejës dhe Klinës.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga rezervat e Qeverisë si në vijim:
 - 2.1. Komunës së Istogut 300,000.00 euro;
 - 2.2. Komunës së Pejës 70,000.00 euro dhe
 - 2.3. Komunës së Klinës 30,000.00 euro
3. Obligohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, që të themeloj dhe udhëheq një Komision të Përbashkët me institucionet tjera për vlerësimin përfundimtar të dëmeve.
4. Obligohen ministrinë e Qeverisë së Kosovës që për institucionet dhe objektet që i kanë në komunat e lartcekura t'i rregullojnë me buxhetin e tyre.
5. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal për zbatimin e këtij vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAQI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë